



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 19 JANAR 2015**

**SA VANREDNE PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE
KOSOVA, ODRŽANE 19. JANUARA 2015. GODINE**

**JANAR - JANUAR
2015**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Dnevni red

1. Prvo razmatranje Nacrt zakon o izmeni i dopuni Zakona br.04/L-035 o reorganizaciji pojedinih preduzeća i njihove aktive.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 69, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa, ka kërkuar mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur sot, më 19 janar 2015, ka vendosur që Kuvendit t'ia propozojë Shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Deputetë të nderuar,
Para se të fillojmë me shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, Kuvendi duhet të vendosë për shmangie nga dispozitat e Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin e projektligjeve.

Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në mbledhjen e mbajtur më 19 janar 2015, e ka shqyrtuar projektligjin në parim dhe ka propozuar që shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre të bëhet me procedurë të përsheptuar, pra me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Muhamet Mustafa që ta arsyetojë propozimin.

MUHAMET MUSTAFA: Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka mbështetur kërkesën e Qeverisë që ky projektligj të futet në procedurë të përsheptuar, duke e shmangur Rregulloren.

I ftoj të gjithë deputetët që ta votojnë këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Profesor!
Atëherë i ftoj kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës!

ADEM GRABOVCI: Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah këtë dhe do t'i japë mbështetje.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës!

ISMET BEQIRI: Edhe ne e mbështetim dhe do ta japim votën tonë për këtë propozim.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”!

VISAR YMERI: Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosjes” është kundër këtij propozimi, sepse ne insistojmë që të vazhdojmë me rrugën për të cilën jemi marrë vesh të premtën, përkatësisht të martën e javës së kaluar, kur Kryesia pati vendosur që ta procedojmë me procedurë të përshpejtuar dhe shmangie nga Rregullorja Ligjin për ndërmarrjet publike, plotësim-ndryshimin e tij, me të cilën ishte ideja që “Trepçën” ta shndërrojmë në ndërmarrje publike.

Këtë ligj ne e kemi diskutuar në Komisionin për Zhvillim Ekonomik të premtën dhe unanimisht të gjithë kanë qenë të pajtimit që të hënën ta diskutojmë këtë ligj dhe ta miratojmë atë, e tash e kemi një ndryshim rrënjësor, drastik të them ashtu, të qëndrimit të kursit të shtetit, i cili po e shndërron shtetin tonë në një lloj skizofrenie, ose institucionet shtetërore në një lloj skizofrenie, të cilat nuk e dinë kur se çka është reale dhe çka është e mundshme dhe e bëshme.

Në këtë drejtim, ne konsiderojmë që kjo mënyrë të cilën po e procedojmë sot, e cila formalisht dhe në vete mund të duket në rregull, është në fakt vetëm një zvarritje me rreziqe të shumta dhe qëllimkëqija që bëhet për ta zëvendësuar idenë e parë, e cila me problemet që i ka pasur ka qenë shumë më e mirë se sa kjo që është sot.

Po ashtu, të mos harrojmë se kjo seancë e sotme, pra e orës 17:00, vjen pas anulimit të seancës së orës 10:00, siç ishim marrë vesh javën e kaluar, dhe pas ndërhyrjeve, kërcënimeve, trysnive dhe takimeve me Qeverinë e Beogradit, ose me produktin e saj, strukturën e saj brenda Qeverisë së Republikës së Kosovës, që është e trupëzuar në Listën serbe, dhe në këtë drejtim ne e shohim si ndryshim të kursit nga Qeveria e Republikës së Kosovës për t’iu përshtatur ashtu kërkesave të Qeverisë së Republikës së Serbisë, duke iu nënshtruar asaj politikisht edhe në këtë çështje.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do të votojë kundër, edhe kundër kësaj praktike, meqë seancën e Kuvendit të Kosovës e shtyn Vuçiqi nëpërmjet Isës dhe Hashimit, siç ndodhi në mëngjes. Dhe, ne pritëm, kryetar, që ashtu siç u raportua ndërkohë në media, të shtyhet për datën 21, sepse po shihet që dobësia e kryeministrit tani po e sjell situatën që vendimet për Kuvendin e Kosovës të merren në Beograd.

Veprimet emergjente, të cilat bartin rreziqe dhe të panjohura në vetvete vijnë si dështim i Qeverisë Thaçi që ta jetësojë Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës të datës 17 prill 2013, ngase në këtë rezolutë Qeveria e Kosovës është obliguar që në afatin prej 90 ditësh nga ajo datë t’i propozojë Kuvendit projektligjin e veçantë për “Trepçën” dhe sot me veprimet tuaja ju, në fakt, i konfirmuat dyshimet që Qeveria në vazhdimësi, prej vitit 2007 e deri më sot, ka qenë e interesuar që “Trepça” të falimentojë për interesat e veta

dhe të mos mbrohet me një ligj, ose me veprime të cilat kanë qenë edhe propozim i Kuvendit, të dalë nga ajo rezolutë.

Me këto ndryshime, të cilat i ka sjellë sot Qeveria Mustafa, në fakt, po e përlligj një të panjohur me propozime, me të cilat mendoj se nuk është vetëm shtyrje e një afati për riorganizim, sepse këtu ka shumë nene kontestuese.

Vetë fakti që ky ligj ka dalë si përshtatje nga Rregullorja e UNMIK-ut 2005/48 tregon shumë.

Në anën tjetër, nëse ky ligj është miratuar më 22 shtator 2011 dhe deri më sot nuk ka pasur asnjë plan të riorganizimit, pse mund të shpresojmë që me një afat shtesë do të bëhet diçka që shkon në favor të zhvillimit të “Trepçës” dhe në favor të zhvillimit të Kosovës.

Ky veprim sot është i paprecedent, qoftë edhe në kuptimin e thirrjes së seancës së jashtëzakonshme, e cila u anulua pas kërkesës së Beogradit, pastaj thirrjes së seancës tjetër të jashtëzakonshme, e cila në vetvete nuk e prodhoi asnjë dokument, i cili mund të diskutohet sot.

Grupi Parlamentar i Aleancës, ashtu siç e kemi thanë edhe në fillim, të vetmin dokument të cilin e votojmë është plotësim-ndryshimi i Ligjit për ndërmarrje publike, përndryshe të gjitha veprimet e tjera do të jenë në fakt dorëzim para Serbisë, e kjo është e papranueshme.

Edhe një herë po e ritheksoj, deputetët e Aleancës do ta votojnë vetëm Ligjin i cili ka qenë i paraparë të votohet sot në mëngjes për kthimin e “Trepçës” në ndërmarrje publike, me qëllim të evitimit që “Trepça” të merret nga Serbia.

Të gjitha veprimet e tjera që po kalkulohen me përpjekje për ta evituar sjelljen dhe ndryshimin e këtij ligji, në fakt janë rënie nën presion para Serbisë dhe deklaratave që dëgjuam dje nga zyrtarët e saj dhe të cilat u përkrahën nga ministrat e Republikës së Kosovës dhe vartësit e Isa Mustafës, të cilët nga Beogradi, nga Serbia, na dërguan porosi ‘mos e prekni “Trepçën”’ dhe me të vërtetë kryeministri i tyre i dëgjoji, sepse u spostua.

Ky është një rast i papërgjegjshëm, i paprecedent, me të cilin nuk pajtohem as ne, nuk pajtohen as qytetarët dhe reagimet janë të shumta.

Do të luftojmë dhe do të kërkojmë që Projektligji për “Trepçën” të sillet në Kuvend sa më parë, ndërsa sot të procedohet me atë që e kemi marrë si material nga dokumentet zyrtare para dy ditësh për një seancë të jashtëzakonshme, të cilën ne publikisht e kemi përkrahur, në mënyrë që të ndalet kjo qasje në raport me “Trepçën” dhe në mënyrë që të ofrojmë një zgjidhje permanente.

Të nderuar kolegë deputetë,

Pasi Qeveria është e pa shpresë që do të ndërmarrë ndonjë veprim të mirëfilltë për vendin, unë ju drejtohem ju: “Trepça” është simbol i rezistencës, ndërsa Isa dhe Hashimi mund ta falin pronën e vet, por jo “Trepçën” dhe jo pronën publike.

Nëse janë të shantazhuar me burg, le të shkojnë dhe le të kryejnë burgun, se asgjë nuk e gjen Kosovën pa ta, mirëpo nuk guxojmë dhe nuk guxojmë të lejojmë në asnjë mënyrë që ta falin asetin kryesor të vendit.

Ju thërrasim që të reflektoni sot, pa dallim të partive politike. Ky dokument që është sjell nga Qeveria është një mashtrim.

Neni 2 thotë që gjykata mund, po e ritheksoj, mund ta shtyjë vendimin për likuidim të “Trepçës”. Kush na garanton sot që gjykata e shtyn vendimin të cilin e ka marrë për likuidim deri më datën 2 shkurt.

Unë edhe një herë ju thërras si deputete, edhe në emër të Aleancës, që të reflektojmë në një tjetër shkurt të vitit 1989, pikërisht 20 shkurti, kur minatorët në “Trepçë” u futën në grevë për ta mbrojtur grevën përballë regjimit, i cili kërcënonte deri në vrasje. Ne sot nuk jemi të kërcënuar dhe ju nuk jeni të kërcënuar as me vrasje, as me vdekje. I detyrohemi këtij vendi dhe këtij populli dhe gjeneratave, të cilat do të vijnë pas nesh, që të veprojmë dhe ta ndalim Qeverinë në këto veprime të saj të marra dhe të papranueshme. Faleminderit!

KRYETARI: Lista serbe!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!
Poslanička grupa Srpska lista podržava ovaj predlog i glasiće se za.

KRYETARI: Grupi Parlamentar “Nisma”!

JAKUP KRASNIQI: I nderuar kryetar,
Të nderuar deputetë,

Po i drejtohem kryeministrit, Kabinetit qeveritar, e sidomos ministrave të fushave financiare e ekonomike, nëse e dinë se çka kanë sjellë para dite në Kuvend dhe çka po sillni pas dite? Çka është kjo hallakatmë tek Ju, zoti kryeministër? Çka u ka hyrë lepuri në bark? Kujt po i frikësoheni? Popullit, apo dikujt tjetër?!

Mënyra se si po kërkoni nga Kuvendi që të vendoset për pasurinë kombëtare, duke e ditur gjendjen ekonomike e politike të këtij vendi, rëndësin dhe kompleksitetin e “Trepçës”, mendja na thotë se ju nuk po e dini se çka është qeverisja, nuk e dini se çka është politika, e as ekonomia, nuk e dini çka është e si menaxhohet pasuria kombëtare, prandaj ose jeni të frikësuar nga dikush, apo ju jeni të shantazhuar nga dikush. Cilado që të jetë, qoftë frika, apo qoftë shantazhi, vendi në këtë mënyrë nuk mund dhe nuk duhet të qeveriset. Nëse nuk janë as njëra e as tjetra, këto pozita që i keni u kanë ardhur, siç thotë populli, si “hutit në zguer”.

Në fakt, në Kosovën tonë gjatë këtyre viteve, e kam fjalën për përgjegjësitë më të larta të shtetit, njerëzve u kanë ardhur pozitat, si në lojërat e fatit, “Gërvisht e fito”!

Ju me këto veprime po tregoni se nuk e keni idenë sesi qeveriset një vend, siç është Kosova, që para 6-7 vjetësh e ka shpallur pavarësinë dhe para 15 vjet ka dalë nga një luftë e egër.

Ju në Kuvend e keni sjellë një ligj me nguti të panevojshme dhe nuk duhej të vinte kështu siç ka ardhur.

Ju, pa mbaruar gabimi i parë, e bëtë të dytin. Po kërkoni që me një seancë të jashtëzakonshme ta ktheni gjendjen ekzistuese të “Trepçës” në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Kësaj i thonë: të bëj diçka, për t’u dukur se po bëj diçka!

Platoni, disa shekuj para erës sonë, padrejtësi më të madhe e quante përpjekjen për t’u dukur si e drejtë. Ju po dëshironi të dukeni se po dini të qeverisni! Ndoshta është në natyrën njerëzore dukja sa për sy e faqe!

Te ne, është akoma më keq. Po dukeni se po qeverisni me shtetin, kur sheshazi po qeveris kushdo tjetër, vetëm ju jo.

Ka edhe shumë arsye të tjera, por mjaftojnë këto që i thashë, që ju të kërkoni që kjo çështje të hiqet nga rendi i ditës. Kjo është puna më e mirë që mund ta bëni sot.

Qeveria duhet ta sjellë në Kuvend një raport për gjendjen në “Trepçë”, një arsyetim pse duhej të bëhej kjo tërheqje taktike e saj?! Të na argumentoni se cila është zgjedhja më e mirë për “Trepçën”, e jo kështu me nguti? Diçka tjetër paradite, e diçka tjetër pasdite. Duhet të na tregoni, ose të na tregojnë shefat e vërtetë, pse “Trepça” nuk bën të shpallet ndërmarrje publike, bile e një rëndësie të veçantë?

Kabinet qeveritar, kështu si po kërkoni ju të vendoset për kryepasurinë kombëtare “Trepçën”, e kam bindjen se ju nuk do të vepronit as me një arë që ua kanë lënë baballarët.

Në fakt, me pasurinë e baballarëve tuaj, vëllezërit nuk do t’u lejonin ta bënit këtë që ju po e bëni sot me pasurinë e Kosovës.

Po kërkoni që ky Kuvend ta marrë një vendim të ngutshëm, vendim që do t’u kushtojë brezave të këtij vendi! Do të ishte turp i madh të bëhet kjo në Kuvendin tonë, por në fund të fundit, populli thotë ‘turpi me bukë nuk hahet!’

Ne do të jemi kundër, kundër do të jenë edhe qytetarët e Kosovës, prandaj në asnjë rrethanë nuk do t’i nënshtrohemi diktatit të pakicës. Privilegji për pakicën është diskriminim për shumicën!

Diktati i pakicës në demokraci është diktaturë, është fashizëm, është banditizëm, por jo demokraci.

Ju duhet të tërhiqeni nga vendimmarrja me nguti, se këto vendime janë duke u marrë nën një shantazh të egër.

Ju kisha sugjeruar ta rishikoni mundësin e tërheqjes nga qeverisja, pasi nuk keni kaçik për të qeverisur me Kosovën!

Edhe një arsye tjetër ekziston: po të hiqet ligji i paradites, jo pse i duhet Kosovës dhe qytetarëve të saj, po hiqet “Trepça” nga rendi i ditës për t’u rikthyer në bisedimet të Brukselit, dhe kjo është ana më e keqe që ka mundur t’i ndodhë këtij vendi dhe këtyre qytetarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar “6+”.

MYFERA ŞINIK: Teşekkür ederim.

Sözkonusu teklifi “6+” Parleментар grubu desteklemektedir. Öyle ki oylamaya sunulduğunda oyumuzu da kullanacağız. Teşekkürler.

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në formë rekomandimi të propozimit të Komisionit Funkcional për shmangie nga Rregullorja, në përputhje me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit, lidhur me afatet kohore për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Në sallë janë të pranishëm 109 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Në fakt, në sallë janë 109 deputetë, por në votim dalin 104, një është pa kartelë, që domethënë 105.

(Reagime nga salla)

Më fal Donikë, jemi para opinionit publik! Mos u mërzit, nuk do të ketë kontrabandim.

Edhe një herë, ju lutem! 109 deputetë janë të pranishëm në sallë. Kanë votuar 104, një është pa kartelë. Cila është vota juaj, a ka mundësi të deklaroheni? Për? Atëherë konstatoj se me 71 vota për, 34 kundër dhe ka abstenim? Edhe një herë! Një abstenim është. Ta kalkulojmë, 2/3. Është çështje matematikore, ju lutem.

Atëherë më lejoni, ju lutem, të më përcjellin të gjithë deputetët e pozitës dhe të opozitës: gjithsej janë 106 vota, 105 me votim elektronik, 1 votë ai zotëria deputet atje, i cili ka

votuar për. Duke pasur parasysh këtë, votat elektronike janë 70 për dhe një, ai zotëria atje, 71 janë për; 34 janë kundër, 1 abstenim.

Me këtë, Kuvendi e miratoi propozimin e Komisionit FunkSIONAL për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit lidhur me afatet kohore për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

(Reagime nga salla)

Ju lutem, pauzë 10 minuta, konsultohuni ndërmjet veti!

KRYETARI: Veç pak, ju lutem! Mos bërtitni shumë! Urdhëro, e do fjalën? Urdhëro, vazhdo, të lutem! Dëgjoni, ju lutem, shkoni qetë se jemi edhe para opinionit publik! Urdhëro, do ta vazhdosh deklaratën. Edhe para opinionit publik, edhe para të gjithëve. Dëgjo, vetëm ju lutem, jo me sjellje që nuk na kanë hije. Secili do ta marrë fjalën. Nuk e kemi ndërmend ta tejkalojmë. Ju lutem, Jakup Krasniqi e ka fjalën.

JAKUP KRASNIQI: Shmangia e Rregullores është në nenin 84 të Rregullores së Kuvendit. Për t'u shmangur Rregullorja e Kuvendit vendoset me 2/3 e deputetëve të Kuvendit të pranishëm në mbledhjen plenare. Shmangia mund të bëhet kur nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Rregullores së Kuvendit dhe me standardet evropiane. Kështu thuhet në nenin 84 të Rregullores.

KRYETARI: E falënderojmë shumë ish-kryetarin e Kuvendit. A ke dëshirë, Visar? Urdhëro!

VISAR YMERI: Atëherë edhe një herë: ju e konstatuat që në sallë janë 109 deputetë apo jo, e kjo është e regjistruar në procesverbal. 2/3 e 109-shit janë 72,3 deputetë, por meqenëse këtë 0.3 nuk mund ta marrim, janë 72 deputetë. Vota pozitive për shmangie i ke vetëm 71, që i bie se nuk ka kaluar propozimi për shmangie të Rregullores.

KRYETARI: Edhe një herë, ju lutem!

Ajo çka është kryesore, së pari jemi qenie njerëzore të gjithë këtu. Nuk do të bëjmë asnjë ndryshim fizik dhe as nuk mund ta bëjmë, ju lutem! Unë thashë 109 deputetë, nga kjo Administratë e Kuvendit më ka ardhur këtu se kanë qenë të pranishëm. Isha shumë korrekt me ju se 105 deputetë votonin në mënyrë elektronike, gjersa një në mënyrë fizike. Domethënë 106 deputetë ishin futur në procesin e votimit, derisa 3 vota, të cilat ju po i kontestoni tash aktualisht, unë nuk marr përgjegjësinë për arsye se ju i numëroni vetë sa janë.

Ajo çfarë them unë, nga 106 deputetë, të cilët janë të pranishëm në pjesën e votimit, për janë 71, 34 janë kundër dhe 1 abstenim. Me këtë përlllogaritje del kjo. Por, ne mund, askush nuk na ndalon, për hir të korrektësisë, ta bëjmë praninë në mënyrë fizike, mund ta bëjmë votimin në mënyrë fizike edhe dalim në rezultat. Këtu askush nuk mund të manipulojë prej meje asnjëri nga ju. Në qoftë se dëshironi futemi me prani fizike, me

ngritje dore sa janë të pranishëm. Ju lutem, vetëm një përfundim duhet ta kemi brenda kohës sa më të shkurtër.

(Reagime nga salla)

Me 106 vota kalon. Ju lutem, të mos krijojmë konfuzion. Ju kisha lutur t'i ndërkrejmë diskutimet, të mos të krijojmë konfuzion. A e besoni së të qenë këtë votim? Administrata? Ju lutem, do të veprojmë menjëherë. Ju lutem, prania? Kam dëshirë ta kem praninë e deputetëve këtu në sallë, pa mënyrë elektronike.

(Reagime nga salla)

Deputete e nderuar! Nuk ka nevojë të më shpjegosh matematikë, por ju lutem a ka mundësi që ta kemi praninë dhe të shkojmë prapë me votim fizik. Vetëm pak, jemi para opinionit publik! Ju lutem, prania fizike e deputetëve në sallën e Kuvendit të Republikës të Kosovës aktualisht është 108. Unë do t'i bie ziles edhe një herë në qoftë se dëshiron dikush ende të futet në sallë. Atëherë të përgatitemi për votim! Jo, të përgatitemi për votim. E gjithë Kosova e shikuar, jemi në transmetim. Përgatituni për votim, ju lutem!

Donikë, të lutem, të mos i ikim realitetit. Në qoftë se dëshironi në atë formë, është aprovuar, është miratuar. Unë dëshiroj edhe një herë. Atëherë, kush është për? A ka mundësi me ngritje dore? Ju lutem, të gjithë kush është për?

Ju lutem, Administrata e Kuvendit! Kush është për propozimin e Komisionit Funkcional për shmangie nga Rregullorja për pikën e rendit të ditës? Ju lutem, kush është për ?

Atëherë, u realizua. I nderuar, Visar! Atëherë është kryer! Unë për ju jam duke e bërë edhe një herë.

Edhe një moment, ju lutem! Nuk do ta lejoj askënd të më vërë në konfuzion të parimit tim për hir të vërtetës. Ta keni parasysh! Futuni në votim, mos u frikësoni para demokracisë dhe para votës. Ose është e mirëqenë, ose është e kryer.

Po e hedhim edhe një herë në votim, ju lutem!

Kush është për le ta ngre dorën dhe do të shkojmë shpejt. Ju lutem, numëroni kush është për. Aktualisht janë 109 deputetë në sallë. Mos lëvizni deputetë, ju lutem! 109 deputetë janë në sallë. Kush është për? Kush është kundër? Ok! A ka abstenim? Herën e kaluar ka qenë abstenim. Nait Hasani është abstenim. Ka abstenime ende.

Me 76 vota për, 1 abstenim...

(Reagime nga salla)

Më falni, në ndërkohë do t'jua lexoj një tekst, i cili është i shkruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, që do të thotë se deputeti konsiderohet se është duke marrë pjesë

në seancë vetëm nëse ai ose ajo i plotëson të gjitha obligimet e lartpërmendura, që nënkupton hedhjen e votës, qoftë për, qoftë kundër, qoftë abstenim. Ju lutem, atëherë ka kaluar me 76 vota për. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre

Konstatimet hyrëse: Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për miratim në parim. E ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotëri Isa Mustafa, që ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ne kemi propozuar sot që të futet me urgjencë trajtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për organizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Qëllimi themelor i propozimit të këtij ligji është që ne të krijojmë kushte që “Trepça” të punojë në mënyrë normale, që të përgatitet plani i riorganizimit të “Trepçës”, të përgatitet strategjia lidhur me “Trepçën” dhe po ashtu sot si Qeveri kemi vendosur që t’jua ofrojmë edhe Ligjin për ndërmarrjet publike, me të cilat ne e kemi definuar organizimin e “Trepçës” me ligj të veçantë dhe mënyrën e organizimit të “Trepçës” sipas ligjit të veçantë.

Me këtë ligj ne kemi bërë përpjekje që të krijojmë parakushte, në mënyrë që të parandalohet procesi i falimentimit të “Trepçës” dhe ju siguroj se ky ligj e parandalon atë. Do të thotë, e parandalon inicimin, në të vërtetë marrjen e vendimit lidhur me procesin e likuidimit.

Ju e dini se Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme ka marrë vendim me të cilin e ka refuzuar kërkesën e AKP-së për zgjatjen e afatit për dorëzimin e planit të riorganizimit të “Trepçës”. Ka afat është përcaktuar deri me datën 2 shkurt. Në qoftë se plani i riorganizimit të “Trepçës” nuk ofrohet deri më 2 shkurt, atëherë mund të fillojë procedura e falimentimit të “Trepçës” në bazë të kërkesës së kreditorëve.

Ne me asnjë vendim nuk mund të abrogojmë vendimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme, që ka të bëjë me afatin për dorëzimin e planit të riorganizimit të “Trepçës”, mirëpo me këtë ligj i krijojmë kushtet që ta pamundësojmë fillimin e procesit dhe marrjen e procesit për likuidimin e “Trepçës”. E japim një afat prej një viti, një viti e gjysmë, që ka mundësi të ofrohet plani për organizim të “Trepçës” dhe po ashtu jepet edhe një afat shtesë me të cilin AKP-ja mundet të kërkojë nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme për zgjatjen e afatit për dorëzimin e planit të riorganizimit.

Kjo është një hapësirë të cilën ne ia krijojmë vetes e “Trepçës” dhe AKP-së, në mënyrë që të kryhen të gjitha procedurat sa i përket riorganizimit, pa rrezikuar në falimentimin e

“Trepçës”, prandaj askush nuk ka nevojë që këtu ta trajtojë se ne tash po e tradhtojmë “Trepçën”, sepse ne me këtë nuk po e tradhtojmë, por kjo është mënyra më e mirë që ne ta zgjidhim problemin aktual të “Trepçës”, te i cili kemi ardhur për shkak të një vendimi që është sjellë, e të cilin ne nuk dëshirojmë ta cilësojmë, por dëshirojmë ta cilësojmë si vendim të gjyqësisë, i cili duhet të respektohet, por i cili, në bazë të kësaj, e pamundëson që “Trepça” të shkojë në procesin e falimentimit.

Prandaj, ne kërkojmë që ju ta përkrahni këtë ligj dhe po ashtu me procedurat të cilat i përcakton Kryesia e Kuvendit, në Kuvend do të vijë edhe Ligji mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të ndërmarrjeve publike, me të cilin ne do të përcaktohemë që çështja e “Trepçës” të rregullohet me strategji për “Trepçën” dhe të rregullohet me ligj të veçantë, duke nënkuptuar pastaj, duke u thirrur edhe në këtë ligj, sepse ky ligj e krijon një moratorium të zbatimit të vendimeve sa i përket procesit të likuidimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!

Të nderuar deputetë,

Pas prezantimit të projektligjit, hap debatin për diskutim në parim.

Kryetari i Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit!

I nderuari kryeministër i Kosovës dhe të nderuar ministra,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, e ka mbështetur Projektligjin lidhur me ristrukturimin e ndërmarrjes dhe pasurive të caktuara. Në këtë rast, komisioni me shumicë votash është i bindur se ky ligj hap perspektivën reale të konsolidimit dhe të transformimit të Trepçës. Në komision ka mbretëruar një debat konstruktiv, i cili ka qenë i orientuar që të krijohen kushtet reale që “Trepça” ta marrë rrugën e zhvillimit.

Duke pasur parasysh nevojën që edhe komisionet të inkuadrohen në trajtimin e dytë, zoti kryetar i Kuvendit propozojmë që leximi i dytë të bëhet nesër, në orën 14:00.

(Sqarime: Sonte!)

Në qoftë se është sonte, mirë! Le të vlerësojë Kuvendi dhe e bëjmë. Zoti kryesues, në qoftë se pajtoheni, do ta shpreh edhe qëndrimin e Grupit Parlamentar të LDK-së. Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryesues i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah raportin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti, Industri dhe Infrastrukturë lidhur me projektligjin i cili është në procedurë.

Grupi Parlamentar konsideron se me këtë projektligj dhe me aprovimin e tij sot në Kuvend tejkalohet rreziku potencial i hyrjes së “Trepçës” në procedurë të falimentimit, që do të mund të ndodhte për shkak të dështimeve të AKP-së, përkatësisht të Bordit të saj për të qenë funksional dhe sipas dispozitave të Ligjit për organizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pronësisë së tyre të cilin po e ndryshojmë sot me procedurë, pikërisht për t’i ndaluar këto.

Prandaj, e vërteta është që ne me këtë ligj po e parandalojmë. Votimi kundër këtij ligji do ta rrezikonte “Trepçën”, kurse votimi për këtë ligj e shpëton “Trepçën”.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike dëshiron të tërheqë vërejtjen se me ligjet në procedurë nuk është hapur, e as që mund të hapet debati se e kujt është “Trepça”. Kjo nuk është temë as sot, as nesër. “Trepça” i takon vetëm Kosovës, qytetarëve të saj të të gjitha etnive pa diskriminim dhe për fatin e saj vendosin përfaqësuesit e qytetarëve të Kosovës në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Askund tjetër!

Pretendimet që dëgjohen nga Qeveria serbe nuk janë asgjë më shumë se një përpjekje joserioze dhe një bluf, sepse ata po të kishin ingerenca e kompetenca rreth “Trepçës” nuk do t’i paraqitnin kërkesat dhe pretendimet e tyre si kreditor në institucionet e Kosovës, përkatësisht në institucionet e formuara me ligjet e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ata mundohen që të thirren në ligje dhe situata e fonde fantome, të krijuara nga regjimi i Milosheviqit, gjoja për të krijuar hise në “Trepçë”, ligje dhe akte këto të cilat janë anuluar për shkak të karakterit të tyre diskriminues nga administrata ndërkombëtare dhe UNMIK-u dhe ato nuk mund të prodhojnë asnjë efekt lidhur me “Trepçën”.

Ajo që do të duhej të pritnim nga Qeveria serbe si minimum në procedurat e hapura të normalizimit të marrëdhënieve dhe negociatat, normalizimit të marrëdhënieve si dy vende fqinj, në këtë kohë do të ishte që kjo Qeveri të distancohet nga ato ligje që kanë sjellë aq fatkeqësi për Kosovën, për shqiptarët, por edhe për serbët dhe pakicat e tjera në Kosovë.

Projektligji që po e trajtojmë sot parandalon hapjen e procedurave të likuidimit dhe falimentimit të ndërmarrjes shoqërore “Trepça” duke krijuar një hapësirë kohore të arsyeshme brenda së cilës ligji i veçantë mbi “Trepçën”, konsolidimin dhe transformimin e saj të vjen në procedurë bashkë me strategjinë në të cilën Qeveria e Kosovës u zotua sot. Dhe, ky Kuvend duhet të krijojë kushtet për zhvillimin e kësaj strategjie dhe për zhvillimin e “Trepçës” në dobi të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Dëshiroj të theksoj se në këtë proces, kërkesat reale dhe të bazuara të kreditorëve do të bazohen brenda kornizës ligjore në Kosovë, e cila është më e avancuara në rajon, që është në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe nuk është në asnjë formë diskriminuese.

Por, kjo kornizë dëshiroj t’ua tërheq vërejtjen të gjithë pretenduesve që bëjnë blofe, nuk lejon asnjë hapësirë për kërkesa të sajura, të pa bazë dhe që në fakt kanë, janë vetëm një bluf politikanesk. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë mendoj që propozimi që të votohet ose të shqyrtohet edhe në lexim të dytë sonte, kuptohet në qoftë se miratohet në lexim të parë, mendoj se është mirë të votohet tani pastaj të vazhdojmë me diskutimet që janë paralajmëruar të deputetëve.

Thërras deputetët që janë jashtë le të futen në sallë për të votuar. Pra, në qoftë se doni ju kryetarët e grupeve parlamentare, por besoj që jeni dakord me propozimin e komisionit dhe të kryeministrit që nëse miratohet sonte të vazhdojmë me leximin e dytë, por në përputhje me hapësirën kohore për të cilën ne duhet të jemi rezistentë, sepse duhet të kalojë edhe nëpër komisionet përkatëse, po besoj.

(Ndërhyrje)

Mirë, pra me Rregullore duhet pyetur kryetarët e grupeve parlamentare. Zoti Grabovci, a je dakord me propozimin si kryetar i Grupit Parlamentar?

ADEM GRABOVCI: Plotësisht jemi dakord, Grupi Parlamentar i PDK-së që këtë çështje shumë të rëndësishme ta kalojmë sa më shpejt, sepse është në interes të zhvillimit ekonomik të vendit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

ISMET BEQIRI: Edhe ne e përkrahim që të bëhet leximi i dytë sonte.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, nuk është këtu. Grupi Parlamentar AAK, nuk është këtu. Grupi Parlamentar Lista serbe, zoti Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajući! I Parlamentarna grupa Srpske liste se slaže sa ovim predlogom i glasićemo za taj predlog.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Nisma, nuk është këtu. Grupi Parlamentar “6+”?

FIKRIM DAMKA: Edhe Grupi “6+” e përkrah propozimin e PDK-së.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, të nderuar deputetë, unë në bazë të deklaramit të kryetarëve të grupeve parlamentare dhe të kërkesës së kryeministrit Mustafa dhe kryetarit të Komisionit, Muhamet Mustafa, e hedh në votim propozimin që në lexim të dytë të bëjmë një shmangie nga Rregullorja dhe ta bëjmë leximin e dytë të ligjit sonte. Votojmë tani.

Në sallë janë 75 deputetë.

Për kanë votuar 67 deputetë, kundër janë 2, 1 abstenim.

Konstatohet se miratohet kërkesa e kryeministrit dhe kryetarit të Komisionit, zotit Mustafa, për shmangie nga Rregullorja në lexim të dytë të ligjit.

Vazhdojmë me diskutimet e deputetëve që janë paraqitur për shqyrtimin e parë të ligjit.

Sipas radhës, zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën. Më fal Bekim, do ta bëjmë në emër të grupeve, se e konsiderova të shteruar. Në emër të grupeve parlamentare, kush paraqitet për fjalë? Zoti Besim Beqaj e ka fjalën.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar ligjin në fjalë dhe konstaton se ky ligj që është sot para nesh e ka të vetmin qëllim parandalimin e likuidimit të kompanisë “Trepça”. Pra, nuk flasim shumë për avancim të drejtpërdrejtë të ndonjë procedure të statusit të saj.

Ligji i cili na ka ardhur më herët për ndërmarrjet publike dhe i cili është tërhequr, ka ardhur me nguti, pa analiza të nevojshme politike dhe profesionale dhe si i tillë është tërhequr nga Qeveria dhe besoj që kanë bërë mirë, ndërsa në ndërkohë kërkesa e cila është sot për ligjin i cili do të mundësojë eliminimin e likuidimit të “Trepçës” ne besojmë që të gjithë deputetët dhe PDK-ja do ta përkrahë dhe Qeveria do të jetë më e organizuar dhe të ketë qasje më serioze që mundëson ky ligj që ta shfrytëzojnë kohën profesionalisht dhe politikisht dhe të sjellë një ligj, i cili do të jetë në interes të ndërmarrjes së “Trepçës” dhe të popullit të Kosovës.

Ftoj deputetët e Parlamentit që ta votojnë këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike e ka bërë Muhameti. Grupi Parlamentar Vetëvendosje, nuk është. AAK, nuk është. Lista serbe, Milosavljeviq ose dikush. Nuk është paraqitur askush. Nga “6+” a dëshironi të flisni në emër të Grupit Parlamentar? Jo. Në rregull.

Ka kaluar. Atëherë fillojmë me deputetët e paraqitur. Thash Bekim Haxhiu, meqenëse ishte në radhë i pari.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryesues,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është më se e evidente se ne në shtator të vitit 2011 miratuam ligjin numër 04-L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre. Ky ligj është miratuar me qëllim që “Trepçës” t’i hapet rruga e riorganizimit dhe me këtë edhe rruga e zhvillimit të saj.

Duke ditur rëndësinë e “Trepçës” edhe këtë nismë tani dhe veprimet e deritashme i konsideroj të vonuara, sepse Kuvendi i Kosovës është dashur që në legjislaturën e parë ta trajtonte “Trepçën” si aset nacional dhe zhvillimor të saj, që atëherë do të duhej të ndërtohej strategjia zhvillimore e “Trepçës” dhe me këtë edhe strategjia zhvillimore e vet Kosovës. Pse nuk ka ndodhur një gjë e tillë, të gjithë nga pak jemi përgjegjës për vonesën.

Në legjislaturën e kaluar e miratuar Ligjin për organizimin e ndërmarrjeve të caktuara që në fakt është ligji për “Trepçën” dhe pyes - çfarë ndodhi pas miratimit të këtij ligji që nga viti 2011 deri sot?

Cilat janë arsyet e dështimit të riorganizimit të “Trepçës” dhe pse në ofertat për organizimin e saj bazuar në këtë ligj kishin konkurruar 9 kompani ndërkombëtare.

A u përdor ndonjë dispozitë ligjore e atij ligji nga menaxhmenti i AKP-së dhe ai i “Trepçës” për organizimin e “Trepçës”?

Deri tani jo, prandaj jemi sot këtu.

Pyes: Çfarë bënë trevjetët e fundit menaxhmenti i AKP-së dhe ai i “Trepçës” për zhvillimin e “Trepçës” si aset shtetëror, sepse që nga muaji tetor i vitit 2013 Bordi i AKP-së, bazuar në kërkesat e Dhomës së Veçantë, në vazhdimësi ka udhëzuar menaxhmentin e AKP-së njësisë e “Trepçës” dhe menaxhmentin e “Trepçës” që të përfundojë procesin e riorganizimit dhe t’i njoftojë palët se ka mundësi të ndryshimit në ligj. Dhoma e Veçantë ka kërkuar që të informohet se çfarë kanë bërë, çfarë veprimesh ligjore kanë ndërmarrë ata dhe nuk kemi pasur asnjë veprim.

Në muajin maj 2014, Bordi i AKP-së sërisht ka udhëzuar edhe një herë menaxhmentin e “Trepçës” që të shkruajë në draft-letër për Dhomën e Posaçme ku do të pasqyroheshin shqetësimet lidhur me vonesat e shkaktuara me paqartësitë ligjore të ndërlidhura me procesin e amendamentimit të Ligjit për ndërmarrjet publike.

Është kërkuar që të dërgohet letër në Dhomën e Veçantë dhe çfarë është bërë? Sërisht është kërkuar një shtim i afatit për 18 muaj shtesë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në këtë periudhë kohore, kur po shtereshin afatet kohore dhe ligjore për vendosjen e të ardhmes së “Trepçës” menaxhmenti i saj ka vendosur që të bëjë një kërkesë tjetër në Bordin e AKP-së, kërkesën për lejimin e mjeteve financiare për riaktivizimin e prodhimit në fabrikën e zink-oksidit. Kjo kërkesë aprovet nga AKP-ja e cila lejon që për këtë qëllim të shfrytëzohen 495 mijë euro nga llogaria e ngrirë për blerjen e nevojshme për këtë projekt i cili ishte vlerësuar nga ekspertët në los-benefit.

Të nderuar,

Për informimin tuaj dhe të organeve kompetente të hetuesisë ju bëj me dije se në vitin 2004 “Trepça” veç kishte investuar një herë afro 1 milion e gjysmë euro në aktivizimin e

prodhimit në Fabrikën e zink-oksidit, ku pas një periudhe të shkurtër kohore kishte ndodhur avaria në fabrikë dhe puna ishte ndërprerë pa bërë kurrë shkakun e avarisë dhe dëmin e shkaktuar dhe kostot për riparimin e saj, dhe pa bërë një llogari për përfitimin nga zink-oksidi i shitur dhe pa treguar se ku u tretën pjesët nga lënda e parë e zinkut pas avarisë.

Pra, në kohën kur “Trepça” po shkonte drejt likuidimit, dikush po mendonte që të investonte në një projekt që veç ishte investuar dhe i konsideruar me los-benefit, ku në kohë më parë ishte investuar 1.5 milionë euro dhe kërkoheshin të investoheshin dhe gjysmë milioni euro shtesë dhe me shkuarjen e “Trepçës” në likuidim të gjitha këto do të harroheshin, sikur besoj organet e drejtësisë të vazhdojnë të punojnë.

Andaj kërkoj nga organet e drejtësisë që ‘ex officio’ Prokuroria e Shtetit t’i hetojë aktorët e përfshirë në këtë projekt, menaxhmentin e AKP-së, njësia e “Trepçës” dhe menaxhmentin e “Trepçës” për investimin e projektit me humbje dhe me këtë ka shkaktuar veprën penale nga Kodi Penal i Kosovës, neni 291 dhe neni 290.

Një fakt është evident se “Trepça” dhe pasuritë minerare të Kosovës janë të mbrojtura me Kushtetutë, me nenin 122 të saj dhe ajo mund edhe të sigurohet me ligj të veçantë, andaj nuk ka vend për shqetësim për asnjë nga qytetarët, sepse ne nëse dëshirojmë do ta bëjmë, do ta mbrojmë këtë pasuri minerare të Kosovës me ligj të veçantë. Por, gjithsesi asnjëherë nuk do të hiqen nga llogaria për të kërkuar llogaridhënie nga menaxhmenti i AKP-së i cili në vitin 2012 e kishte marrë në udhëheqje “Trepçën” me mbi 8 milionë e 200 mijë dollarë në konto dhe me 5 mijë ton rezerva të koncentratit dhe “Trepça” në vitin 2012 po operonte me një bilanc pozitiv për mbi 15 milionë euro, ndërsa sot ajo operon me një bilanc negativ dhe ka vështirësi për sigurimin e pagave. Gjithsesi ish ushtruesi i detyrës së menaxherit të “Trepçës” dhe menaxheri aktual i saj, do të duheshin të jepnin llogari për investimet në projekte me los-benefite dhe kjo do të duhej sigurisht që të bëhej nga përgjegjësit kompetentë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Si çdo qytetar i Kosovës në këtë moment, edhe unë... pështillen disa dyshime dhe besoj që organet e drejtësisë do të nxjerrin të vërtetën, a deshi menaxhmenti i AKP-së njësia e “Trepçës” dhe menaxhmenti i “Trepçës” që heshtazi ta dërgojnë “Trepçën” në likuidim për t’i mbuluar projektet me los-benefite dhe keqpërdorimin e mjeteve financiare viteve të fundit dhe disa viteve paraprake.

Dhe pyetja e dytë është, po sikur bllokada institucionale e krijuar pas zgjedhjeve të vazhdonte ende, a do të ishte sot “Trepça” e humbur ligjërisht, andaj iniciatorët e ngërçit politik e kanë për obligim t’u shpjegojnë qytetarëve se bllokada institucionale e krijuar a e kishte këtë qëllim, bllokimin e Kuvendit të Kosovës, ndërsa “Trepça” të shkojë në likuidim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fatmir Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje kolegë deputetë,

Përshëndetje kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Po më habit pak fakti se detyrë parësore e jona si deputetë është megjithatë të kemi një përkushtim më të madh për imazhin dhe punën e Parlamentit ashtu qysh ne flasim, qëndrojmë këtu dhe punojmë kështu do t'i kemi rezultatet dhe imazhin e këtij Parlamenti.

Për këto tema të rëndësishme që po trajtojmë ne si deputetë duhet t'i japim përkrahje këtij qëllimi dhe në këtë moment të duhur Qeverisë për mundësinë që e dha që ka ofruar projektligjin, pra për këto ndryshime aktuale në mënyrë që të bëhet ai parandalim ashtu qysh u tha edhe në fjalën e kryeministrit, por edhe të kryetarit të Komisionit parlamentar.

Ndërsa sa i përket debatit për pasurinë e Kosovës, atë e ka zgjidhur Kushtetuta, prandaj edhe ne duhet të sillemi konform asaj, nuk duhet shumë të bëjmë marketing politik, sepse është përcaktuar me Kushtetutë, i takon qytetarëve të Kosovës dhe ne duhet të menaxhojmë dhe t'i projektojmë strategjitë e zhvillimit të mëtutjeshëm. Në kuadër të kësaj hyn edhe "Trepça", pavarësisht prej fjalëve që u thanë, për historinë që e ka, dhe ne mendojmë që në një moment tjetër të kemi edhe Ligjin për ndërmarrjet publike, ta trajtojmë ashtu si duhet, të bëhen ndryshime adekuate, e bashkë me te të kemi pra edhe mundësinë që të bisedojmë për Ligjin për "Trepçën" dhe po ashtu në afatin sa më optimal ta bëjmë edhe procedimin dhe përfundimin e këtij projektligji.

Deri atëherë, mua më intereson, në qoftë se ka mundësi të vijë Qeveria deri te informata se cila është realisht vlera, vlera e pasurisë së "Trepçës" nëse ka diku që ekziston ndonjë dokument, që ekziston ndonjë e dhënë e një institucioni relevant vendor apo ndërkombëtar në mënyrë që për të marrë vendimin e drejtë si Qeveri e si Parlament duhet ta dimë pra edhe vlerën e saj, sepse është ndërtuar lloj-lloj miti për pasurinë e "Trepçës" gjegjësisht pasurinë që u përmend edhe në Mitrovicë, por edhe jashtë Mitrovicës. Është mirë ta dimë a është 1 miliard, a është 2 miliardë, a është 10 miliardë dhe në qoftë se detyrimet e tjera janë shumë më të vogla atëherë ia vlen politikisht, ekonomikisht dhe strategjikisht që të ndërmerret diçka. Është mirë nëse mund të vijmë deri aty, para se të vjen ligji për "Trepçën".

Ndërsa për ligjin në fjalë e kam vetëm një propozim konkret që do ta themi edhe në Komision. Duke pasur parasysh disa vonesa që kanë ndodhur në të kaluarën, mos të na përsëriten, nuk e di a është e mjaftueshme afati prej 18 muajve, te neni 2 ku plani i alternativës për riorganizim ndoshta është më mirë të bëhet 24 muaj, në mënyrë që të mos na vijnë punët ngushtë, ditët ngushtë dhe sërish të mos e kryejmë. Në qoftë se ka mundësi pra të merret parasysh, këtë e kam parasysh që të mos na përsëriten disa gjëra të cilat kanë ndodh në të kaluarën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën Margarita Kadriu-Ukelli.

MARGARITA KADRIU-UKELLI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Sot, edhe pse opozita po na mungon, në orët e para ditës ne në rend dite e patëm një çështje kruciale, në mënyrë që përfundimisht të tentojmë dhe ta zgjidhim çështjen e Kombinatit “Trepça”.

Mirëpo nga ajo çka pamë nëpër media nëpërmjet një presioni, konsideroj të paligjshëm, i cili së paku nga mediet e shkruara vinte se po na e çon Beogradi nga kryeministri Vuçiq, plani ndryshoi.

Tash, Kabinet qeveritar, u kujtuat se Kombinati “Trepça” i paska 1.4 miliardë euro borxh dhe na njoftuat se po e shtyjmë për nesër diskutimin për ndryshimin e Projektligjit për ndërmarrje publike, ndërkaq, Aleksandër Vuçiqi na tha që jo nesër, por pasnesër do të flitet për “Trepçën”. Pra, pasnesër, të mërkurën flasim për “Trepçën” në Kuvend, domethënë po na dikton.

Qeveria e ka ditur qartë se “Trepça” përballet me kërkesa të shumta të kreditorëve. Shumica e këtyre borxheve të ashtuquajtura të “Trepçës” janë krijuar në kohën e masave të dhunshme dhe si të tilla obligimet i marrin vetë ata kreditorë.

Një nga kreditorët më të mëdhenj është edhe vetë Qeveria e Kosovës, e cila ka investuar rreth 100 milionë euro që nga paslufta, kurse lista e gjithë kreditorëve do të duhej të ishte tanimë publike, ngase Agjencia Kosovare e Privatizimit deri në fund të vitit 2013 ka grumbulluar pretendimet e gjithë kreditorëve potencialë.

Qeveria në mandatin e kaluar ka punuar për gati në një vit përafërsisht për një draft ligj për “Trepçën” i cili u tërhoq pastaj për t’u mjaftuar me ndryshimet e Ligjit për ndërmarrje publike.

Të gjithë e dimë fare mirë se çështja e “Trepçës” nuk është fare e thjeshtë, nuk është punë e lehtë, por së paku ajo çka duhet të bëjmë, hapi i parë, futja e saj nën menaxhim shtetëror.

Tash, a mund të ma sqaroni, sot në gjithë opinionin publik ekzistonte frika, a po kthehemi serish në vitet e ‘80-ta kur Serbia i futi duart thellë në çdo pasuri kosovare, apo çka po ndodh?

Mendoj se qytetarët e Kosovës dhe ne si të zgjedhurit e tyre, meritojmë së paku më shumë sinqeritet nga kjo Qeveri. Thënë shkurt e shqip, ju duhet të jeni të hapur dhe të na tregoni se çka po zihet prapa skenës, ndonëse s’po dua ta paramendoj, a po flitet për diçka që është e kundërligjshme apo kundër-kushtetuese.

Të nderuar, edhe pse u bënë 16 vjet pas luftës të gjitha qeveritë u treguan të pa zonja totalisht për ta zgjidhur çështjen e “Trepçës” e cila vazhdon të funksionojë edhe sot e kësaj dite e ndarë, mu ashtu si komuna e Mitrovicës, ku gjendet kjo ndërmarrje e rëndësishme dhe me asete shtetërore të veçanta në Republikën e Kosovës, serbët e administrojnë një pjesë të kombinatit në veri, ndërkaq shqiptarët janë shefa në jug.

Dikur AKM-ja dhe sot AKP-ja me punën e tyre totalisht të papërgjegjshme dhe hipokrite nuk kanë arritur kurrë ta kenë nën kontroll menaxhimin e ndërmarrjes në pjesën veriore. Auditimet kanë treguar parregullsi financiare dhe abuzime të mëdha, por asnjëherë nuk janë ndërmarrë masa, si në të gjitha segmentet e tjera, edhe në këtë sferë, Prishtina zyrtare ka qenë spektatore, në vend që të jetë lojtar kyç në vendin e vet dhe në shtetin e vet, sot pas presionit nga Serbia, po kërkon që të ndryshoni strategjinë dhe Ligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre. Ta ndryshoni, do të thotë, t'i ndryshoni dy nene. Po e ndryshojmë, burra, po çka më tutje?! Në vitin 2011, deputetët e Kuvendit miratuan Projektligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, që siç u tha atëherë, zoti Beqaj kishte thënë 'i hapi udhë privatizimit të gjigantit metalurgjik "Trepça", projektligj ky pra i hartuar nga MZHE, vend të veçantë në këtë ligj kishte administratori i ndërmarrjes të cilin rol ia dhatë AKP-së.

Tash jemi në fund të muajit janar 2015 dhe Agjencia e famshme Kosovare e Privatizimit ende nuk e ka planin e riorganizimit dhe po ta kishte nuk ka mundësi ta dorëzojë për shkak se s'ka bord të kompletuar.

Ky është edhe një dështim shtesë në listën e dështimeve të pafund, andaj të nderuar jo që nuk u zgjidh problemi, por gjiganti metalurgjik "Trepça" po rrezikon të shkojë në likuidim.

I nderuar Kabinet qeveritar,

Po mendoj se arsyeja që po doni me urgjencë ta shpëtoni çështjen e Kombinatit "Trepça" duke e parë rrezikun nga likuidimi i saj përmes AKP-së, pas një vendimi të Dhomës së Posaçme, është një nismë e drejtë. Pretenduesit për kinse detyrimet që i ka pasur "Trepça" kanë shprehur kërkesat e tyre ndonëse gjithçka po mbahet në një mungesë totale të transparencës nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, një agjenci e stërmbushur në vazhdimësi me skandale për dyshime për keqpërdorime në privatizimin e pronës shoqërore.

Për hapat ligjor për t'ia ndryshuar statusin kombinatit nga shoqëror në publik sot na thatë që po dëshironi të flasim nesër, tash s'po di a do të flasim nesër apo jo. Hajde, po e kthejmë këtë ndërmarrje në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe konsideroj që është e drejtë dhe unë këtë çështje si deputete e këtij Kuvendi do ta përkrah, por sërish shtrohet pyetja, zoti kryeministër dhe zëvendëskryeministër, çka më tutje? Ligji për "Trepçën", çka saktësisht në ligjin për "Trepçën"?

Edhe një herë, të nderuar Kabinet qeveritar dhe deputetë, në rastin e "Trepçës" duhet të tregohet kujdes i veçantë, sepse e tillë është vetëm kjo ndërmarrje me asete të veçanta strategjike zhvillimore nga resurset nëntokësore kosovare për "Trepçën" e cila është pasuri kombëtare e Republikës së Kosovës dhe jo një kompani e thjeshtë që mund të tjetërsohet, institucionet duhet të nxjerrin mësim nga e kaluara, nga gabimet e së kaluarës, më saktësisht në mënyrë që t'i hapet perspektiva e merituar njërit prej aseteve më strategjike dhe të veçanta të shtetit tonë, prej të cilit mund të kenë përfitime të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Boll më me politika të tilla të dështuara, ku Prishtina zyrtare vazhdon të mbetet spektatore për pasuri kombëtare të shtetit tonë, ndërkaq penjtë t'ua tërheqin dikush tjetër nga jashtë Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën Ramiz Kelmendi.

RAMIZ KELMENDI: I nderuar kryetar,
Kryeministër, zëvendëskryeministra, Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,
Sot jemi duke debatuar për Kombinatin “Trepça”, shpëtimin nga falimentimi i shpejtë dhe mos marrjes së obligimeve të shumta fiktive kreditore që pretendohet që ka ky kombinat.

Sot jemi duke biseduar për një kombinat të rëndësisë së veçantë, por jo aq ndikues në ekonominë e Kosovës, sa pretendohet që e ka pasur dikur dhe që do ta ketë tani.

Në “Trepçë” rrethanat ekonomike kanë ndryshuar shumë dhe qëndrimet tona politike duhet ta shtyjnë zhvillimin ekonomik dhe energjitë tona të orientohen pozitivisht dhe jo i tërë spektri politik të preokupohet me pengesat që jepen nga Kombinati “Trepça”. Nuk mund askush të na ndal zhvillimin tonë të veprimtarive të shumta ekonomike e që mund të punësojmë me qindra- mijëra punëtorë, sa që do të punësoheshin disa qindra në “Trepçën” e famshme, që ne po e cekim.

Ne duhet të punojmë ngjeshur në ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve për liberalizimin e tregut ekonomik të Kosovës, thithjen e investimeve të jashtme dhe te brendshme, ashtu siç kemi vepruar me këtë ligj në shpejtësi, në mënyrë që ne t'i hapim rrugë investitorëve për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe punësimin e shumtë të këtyre qytetarëve tanë.

Është dashur të shfrytëzohet edhe ky unitet opozitë-opozitë, siç është sot, por për fat të keq nuk e kemi tani, që ishte për të ruajtur pasurinë e Kombinatis tonë “Trepça”. “Trepça” është e Kosovës dhe nuk ka mundësi askush ta tjetërsojë. Ne mund të vonohemi në realizimin e synimeve tona, por sigurisht që Qeveria jonë do ta realizojë këtë synim me ndryshim-plotësimin e ligjeve dhe do të vazhdojë, që Kombinati “Trepça” të japë për Kosovën dhe - “Trepça” punon dhe Kosova, ndërton. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sadri Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!
Kryeministër,
Zëvendëskryeministra,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë,
Ne tani po diskutojmë këtu, edhe pse në temë i kemi dy çështje, dy problematika që po dallojnë, por, megjithatë ne po i trajtojmë brenda të njëjtës temë edhe unë dua që t'i dalloj në diskutimin tim, këtu.

Po flasim tani pra, për propozim-ligjin 05/L-08, që lidhet me plotësim-ndryshimin e ligjit 04/L-035 dhe që lidhet me afatet e fillimit të procedurave të falimentimit. Dhe, unë mendoj që asnjëherë deri tash nuk dëgjova diskutim as argument që ne duhet ta lejojmë diçka të tillë, prandaj, ky propozim po justifikon angazhimet e ne të gjithëve , por edhe përcaktimet e ne të gjithëve , që ne ta votojmë këtë ligj të propozuar, që të fitojmë periudhën kohore të propozuar 18 muaj dhe ndërkohë, ne pastaj të bisedojmë dhe ta gjejmë modelin, që “Trepçën” e vendos në binarët e zhvillimit dhe perspektivës së mëtejme.

Por, unë mendoj se herët është gabuar kur është menduar se AKP, AKM-ja gjegjësisht AKP-ja do të jetë ajo e cila do ta krijojë strategjinë dhe e cila do të ketë fuqi dhe kapacitet për ta tejkaluar këtë problem. Nuk e kanë atë zanat, s’e kanë atë përkushtim dhe realisht, ne tepër gjatë i kemi pritur që ata ta bëjnë këtë punë. Dhe, pikërisht kjo ka qenë arsyeja, që para një viti e gjysmë në këtë Parlament kemi diskutuar, kemi pasur iniciativa dhe kemi dhënë arsyeshmërinë, që duke u bazuar në rezervat që përafërsisht po i them me numra të rumbullakuar, janë diku rreth njëqindvjeçare me kapacitetin optimal, që punon “Trepça”, duke u bazuar në kapacitetet momentale që i ka “Trepça” në shumicën e njësive që ato punojnë, me mundësi të zgjerimit të njësive produktive, nëse e kanë dorën e kujdesit në raport me ato.

Në kuadrin e nevojshëm, po edhe nevojat që i ka Kosova, kemi propozuar rezolutën, me të cilën e kemi obliguar Qeverinë, dikasteret përkatëse, që të bashkëpunojnë dhe të dalin brenda tre muajve me një ligj të veçantë për “Trepçën”. Si e kemi lexuar ne në atë moment ligjin e veçantë për “Trepçën”, pra modelin e veçantë për “Trepçën”, që të tejkalohet ajo gjendje.

Pse e kemi quajtur asisoj dhe pse tani e quaj kësisoj. Arsyeja është se kur kam menduar se për “Trepçën” do të lexoj tri ditë dhe do ta krijoj idenë, unë e kam parë se sa më shumë kam lexuar ato tri ditë, aq më të paqartë e kam pasur problemin e “Trepçës”. Pra, zgjidhja e problemit të “Trepçës” nënkupton edhe një sfidë, sepse edhe strukturimet, pastaj problemet politike, mënyra e menaxhimit në të kaluarën, pretendimet në raport me borxhet, njëkohësisht unë kam pasur edhe një studim në dorë, që është financuar në kohën e UNMIK-ut nga disa ekspertë ndërkombëtarë, të cilët kanë ardhur, kanë qëndruar gjatë në “Trepçë”, kanë shpenzuar mjete të mira, kanë dhënë një konkluzion sikur të thonë, se ne nuk kemi ide dhe e kanë quajtur me një fjalë “dinozaur” dhe kanë ikur prej Kosovës.

Ngjashëm e ka bërë edhe AKP-ja, ka angazhuar kompani, kinse, i ka orientuar 7-8 milionë dhe ne në fund, për momentin nuk kemi asgjë. Unë thërras të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë, duke i ditur të gjitha këto edhe rëndësinë, që të gjitha idetë t’i ruajmë, t’i akumulojmë dhe t’i shprehim në momentin kur fillon angazhimi për këtë çështje, ndërsa, unë sonte nuk kam fare dilemë që duhet ta votojmë pra, këtë propozim-ligj dhe t’i fitojmë këta muaj, me të cilët ne e fitojmë pra ikjen nga falimentimi, që kishte me qenë shumë i dëmshëm. Por, njëkohësisht sot, nuk di a do të mundemi ta japim edhe një përgjigje, se cili do të jetë bashkëpunimi i AKP-së, i Dhomës së Veçantë dhe i menaxhmentit të “Trepçës”, ngase për një vit të stagnojë puna, nuk është mirë.

Ata duhet të krijojnë relacione të mira, që “Trepça” të punojë me kapacitete të plota dhe të zhvillohet derisa ne nuk procedojmë me ligjin e veçantë dhe me formimin e projektit në raport me “Trepçën”.

Unë e di që kemi ekspertë të mjaftueshëm, e di që ekziston menaxhmenti që mirë e kupton “Trepçën”, por mjafton edhe një ngritje e kapacitetit të plotë edhe të ekzekutivit, legjislativit të vendit, në mënyrë që ne për një afat shumë të shpejtë, vërtet ta krijojmë modelin për ristrukturimin për ligjin për “Trepçën” dhe t’i krijohet perspektiva “Trepçës”, pasurive të “Trepçës” dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën profesor Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit!

Zoti kryetar i Kuvendit,

Zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Një vendim i Gjykatës - Dhomës së Veçantë, i marrë më 9 janar e ka vënë ashiqare në urgjencë Qeverinë e Republikës së Kosovës, me disa veprime, për të mos e quajtur urgjencë edhe një tip paniku, sepse shpejt e shpejt ka reaguar që ky kufi i rrezikshëm i një vendimi gjykate duhet të shtyhet, në mënyrë që të mos krijohet mundësia e likuidimit të “Trepçës”.

Tema e “Trepçës” në këtë Kuvend është shqyrtuar shumë herë. Kuvendi herën e fundit pas një diskutimi shumë të gjatë, i ka rekomanduar Qeverisë së atëhershme në detyrë, që të krijohet një ligj për “Trepçën” dhe, ai rekomandim ekziston. Po them që ekziston histori rreth “Trepçës” dhe nuk ka pasur nevojë, qoftë edhe një vendim i çuditshëm, që merret në njëfarë mënyre më 9 janar, kur dihet që Kuvendi është në njëfarë pushimi të ashtuquajtur vjetor, por unë nuk po shkoj tutje.

Pra, historia e “Trepçës” me Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe me Qeverinë e Republikës së Kosovës e ka një histori. Tash këtu edhe u dëgjua që është provuar që rekomandimi i Kuvendit të kthehet një projektligj, mirëpo Qeveria e kaluar ka menduar që është më mirë që përmes amendamentimit ose ndryshimit të Ligjit për ndërmarrjet publike, mund të kalohet ajo. Dhe, këtu historia mbaron, jemi në historinë e këtij viti.

Pra, Qeveria ka reaguar shpejt dhe Kuvendi po ashtu, shpejt, mund t’ju them që kemi krijuar konsensus në Kryesi të Kuvendit, me shefat e grupeve parlamentare, që të kalohet me shpejtësi propozim-ligji i Qeverisë, që është propozim-ligji për ndryshimin e plotësimin e Ligjit të ndërmarrjeve publike, ku kryesoret kanë qenë dy nene, ka qenë numri tre, amendamenti 3 dhe 5-shi, po citoj: “i cili kërkon që kjo ndërmarrje të bëhet ndërmarrje publike qendrore” edhe vazhdon.

Qeveria sot e tërhoq këtë projektligj dhe kaloi me propozim të kryeministrit këtë të dytin dhe, ne tash jemi në të dytin. Po, pse po i lidh unë? Po i lidh, se s’kemi qare pa i lidhur,

sepse jemi në një ditë me urgjenca dhe jemi ne që kemi kërkuar një urgjencë dhe po e bëjmë urgjencën tjetër. Pra, Qeveria mendon që me projektligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre mund ta arrijë të njëjtin efekt, që të mos e bëjë të rrezikshëm 2 frorin ose shkurtin, për mundësinë e likuidimit.

Dhe, unë tash menjëherë po përpiqem t'i lexoj këto dy të lidhura. Ne kemi marrë këto amendamente për ndryshimin e Ligjit të ndërmarrjeve të caktuara dhe të pronës së tyre, po e kemi edhe me një shpjegim, si i thonë zakonisht këto ligje, memorandumit shpjegues. Unë këtu e kam ministrin e Drejtësisë dhe tash do t'i drejtohem me emër ministrit të Drejtësisë- A është pjesë ligjore, efektive edhe pjesa shpjeguese e memorandumit shpjegues, sepse në këtë rast edhe amendamentet i keni brenda një nenit të memorandumit shpjegues, po jo jashtë tij?

Dhe, pyetjen e di pse e bëj, po e nënvizoj, për shkak se nëse pjesa e memorandumit shpjegues është me fuqi ligjore, në këtë rast, atëherë pika 5 e këtij memorandumit, e pesta ku thotë: "Elementet kryesore të politikës së propozuar, përmbajtja, instrumentet e politikave, kosto, procedurat, e tjera, thotë që edhe më tutje kjo ndërmarrje mbetet nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit."

Po që kjo, objekti i ligjit tjetër, i propozuar, i ndryshuar bëhet "nyl", inekzistent, sepse, nëse ne votojmë që edhe 36 muaj, që i bie edhe 22 plus, se ai nen është, neni edhe sa muaj shtohet, nëse i bie që votohet kjo dhe kjo është pjesë e vlefshme ligjore, atëherë aventura me ndërrimin e tjetrit nuk ekziston. Ligjërisht s'ekziston, se voton diçka që s'ke pse e voton nesër kundër.

Unë po e përfundoj këtë saktësim, me që jam njeri që e kam një dosje të këtyre ndodhive që 5-6 ditë krejt çka ka ndodhur me kërkesat edhe të Qeverisë edhe të Kuvendit, për të qenë i qartë edhe për kolegët edhe për opinionin edhe për Qeverinë. Unë vetëm mund të shtoj, në kuadër të gjithë kësaj, që pasuria nacionale e Kosovës duhet të garantohet me ligj, të mbrohet me ligj, absolutisht.

Gjithmonë është thënë dhe sot u tha, shumë herë me zë të lartë, shumë herë me pak më të lakuar, që "Trepça" është pasuri shumë e madhe nacionale e Kosovës, kjo i bie përtej një qeverie, përtej një institucioni, përtej një gjenerate, pra e të gjitha gjeneratave. Atëherë, kjo duhet të sanksionohet me ligje dhe të mbrohet e mbasandaj qeveritë duhet veprimet t'i kenë të përgjegjshme, se edhe sendin më të vlefshëm është i ndjeshëm e mban në dorë, e rrëzon mundesh edhe pasuritë marramendëse për t'i humbur.

Unë mendoj, që nuk është mirë që në Kuvendin tonë të flitet për "Trepçën" herë sikur një thesar të pafund pasurie e herë të diskutohet si për borxhin e keq. Ekonomistët e dinë më mirë se unë çka është borxhi i keq, po e di edhe unë. Ngadalë, këtu nuk... ajo puna e politikanizmit, mbasandaj që ka marrë edhe ngjyrë pak populliste që "për" ose "kundër" në opinionin publik, unë mendoj që është leksion i hatashëm që është marrë edhe kësaj here, po merret edhe hera tjera, nuk duhet të rrahim gjoks për pa i kryer punët, çfarëdo qofshin.

Dhe e dyta, Kosova ka kufij e ata që dinë, elementare për kufij, pasuritë, kufi i thonë vija që ndan edhe ajrin edhe tokën edhe nëntokën dhe pasuritë me Kushtetutë, nëse janë të Kosovës, pasuritë që ndodhen në Kosovë se janë të Kosovës, nuk mund të tjetërsohen, po të mbrohen me ligje, në veprimtari të tyre duhet dhe kjo duhet të ndodhë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Me këtë ligj ne kemi biseduar edhe në mandatin e kaluar dhe sot jepet përshtypja që ky angazhim kaq i madh në këtë pasdite po bëhet për të shpëtuar nga likuidimi, por për të vazhduar prapë keqmenaxhimin nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

E tillë ka qenë edhe situata, ne kemi kërkuar edhe në komisionin e kaluar, që nga Agjencia Kosovare e Privatizimit të jepet një shpjegim nga aspekti juridik i “Trepçës”, që nga koha e suprimimit të institucioneve të Republikës së Kosovës nga e drejta ndërkombëtare për çështjen e keq-menaxhimit dhe keq-pronësisë, apo mënyrës joligjore të qarkullimit të “Trepçës” tek investitorët, e tjerë...

Ajo nuk është arritur asnjëherë dhe unë mendoj që nuk jemi duke arritur ndonjë gjë, nëse nuk arrijmë të bisedojmë për pronësinë nga aspekti ligjor dhe pretendimet e partnerëve, me të cilët kemi qenë në bashkëjetesë dikur, por divorcimi ka treguar që ajo nuk ka qenë bashkëjetesë, por njëlloj uzurpimi.

Prandaj, nëse ne nuk bisedojmë për pronësinë e “Trepçës” dhe po bisedojmë vetëm për ruajtjen nga likuidimi, mendoj që ne prapëseprapë po vazhdojmë vetëm një kohë, e cila po blihet si kohë, por nuk do të ketë një shpjegim të qartë.

Ne kemi mundësi edhe me letra dhe me dokumente, ka juristë të famshëm edhe këndej prapa edhe përballë, të gjithë shihemi përballë, që të shpjegohet nga aspekti juridik njëherë, mandej të qartësohet edhe nga interesi politik mandej shpëtimi, i cili bëhet edhe nga gjykata, për të cilën kemi dhënë vërejtje shumë serioze.

Ajo gjykatë paguhet nga taksapaguesit dhe nga Agjencia Kosovare dhe në vit më shumë se shtatë ankesa nuk i trajton, kështu që është dashur që ne sonte të bisedojmë për atë gjykatë, jo për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe mandej të dalim tek Agjencia e Privatizimit dhe të tregojmë se likuidimi nuk mund të bëhet. Ne i falënderojmë ndërkombëtarët për ndihmën që na kanë bërë, por nuk duhet ndoshta edhe atë falënderimin me prapavijë t’ua bëjmë, sepse nganjëherë duke na ndihmuar edhe po vjen deri tek një dëmtim serioz edhe i pronësisë, i aseteve minerale të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Megjithatë, tek diskutimi i fundit ne si legjislativ nuk kemi të drejtë të përzihemi në punët e gjykatës, ta kemi parasysh, megjithëse, është çështje shumë emocionale të cilën e kemi trajtuar aktualisht sot, të kemi mirëkuptim edhe në procedurat të cilat zhvillohen, pasi që jemi në pjesën e fundit, ku kërkohet deklarimi për votim. Ta

keni parasysh, të gjithë deputetët konsiderohen të mirëqenë në sallën e Kuvendit, mbase edhe një aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese, veç edhe në momentin kur marrin pjesë në votim, qoftë për, kundër ose abstenim. Kjo ju obligon edhe juve, veçanërisht pjesën e votimit elektronik.

Vazhdojmë të nderuar deputetë, në fakt në bazë të Rregullores, ministri duhet të përgatitet, por në qoftë se e shpreh dëshirën, profesor, nënkryetari i Kuvendit, me dëshirën e madhe, ministri mund të përgjigjet. Vetëm le të urdhërojë.

(Ndërprerje e incizimit)

MINISTRI I DREJTËSISË HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

I nderuar profesor Hamiti,

Unë e kuptova drejt trajtimin tuaj dhe pyetjen dhe dua të them, që nuk janë të barabarta në kuptimin e fuqisë juridike, por ajo çka propozohet sot është që t'i japë fuqi juridike gjykatës, që procesin e likuidimit, respektivisht vendimin për likuidim ta zgjasë edhe për një kohë, për "Trepçën" dhe rastet tjera.

Ndërsa, ligji i veçantë për statusin e "Trepçës" duhet të jetë tjetër, por sot nuk preket statusi i "Trepçës".

(Ndërhyrje)

Vetë fakti që thashë, nuk preket statusi, nënkupton që mbetet ashtu siç është. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Përfaqësuesi i Qeverisë, a e dëshironi fjalën në përfundim?

(Nga salla: Jo!)

Atëherë, të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Në sallë janë të pranishëm 72 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Konstatohet se me 64 vota për, 4 vota kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Kërkohej nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandim për seancën plenare të radhës, që do të mbahet sot, më 19 janar 2015, në orën 20:00. Faleminderit!

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë